

Data 28.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje vegla pune per oficine dhe rregullimin e kazaneve e 150 kosha 120 lt

REF-94549-07-27-2026

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **39300000-5 ; 44511000-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: 13.608.081 (trembedhjetë milion e gjashtëqind e tete mije e tetëdhjetë e një) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mesiperme janë detyruese dhe i sherbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertes është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, si një mjet garancie për Autoritetin Kontraktor në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes

së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

2.1.1. Kjo pike plotësohet me dorezimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2023- 2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 2 germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe është bërë bazuar në Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.26/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse për vitet financiare 2023,2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit për Kontabilitetin dhe

raportimin financiar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në Ligjin nr.29/ 2023, datë 2.05.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM Nr. 922, datë 29.12.2014 *PËR DORËZIMIN E DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE* (Ndryshuar me VKM nr. 211, datë 9.4.2025).

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jete në përputhje me objektin e prokurimit. Certifikata duhet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

2.4.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi. me peshe të lejuar jo më pak se 3500 kg.

Sa më sipër mjeti nevojitet të jete i pajisur me :

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose

- çdo dokument tjetër me anë të cilin fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

Kontratë huaje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- a) Kontratë qiraje.
- b) Leje qarkullimi e mjetit.
- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- ç) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacioni provues do të sillet fizikisht nga operatori i renditur i pari.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat objekt të prokurimi sipas numrave rendor Nr.1 –Nr. 96. Në rast paraqitje të Autorizimit nga distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 40 pika 8, 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

2.4.4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë /fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha mallrat objekt të prokurimit. Katalogu/fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë pajisjet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të

domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me vegla pune profesionale të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike.

2.4.5. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për mallrat objekt prokurimi, sipas tabelës të paraqitur nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 7. Oferta teknike duhet të plotësohet me saktësi nga ofertuesi për të gjithë artikujt e listës. Në plotësim të kësaj kërkesë dokumenti “Ofertë Teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut ose skedës teknike	Referenca në katalog	Shënime (nëse është e nevojshme)
				KOD i produktit ose nr. Faqes në katalog	

- Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7.

- Emërtimi i Katalogut ose skedës teknike të prodhuesit/distributorit të autorizuar. Referenca në katalogje, kodi produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ose skedën teknike përkatëse për çdo produkt ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST.

- Në fushën “SHËNIM” operatori ekonomik ofertues mund të shkruajë sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,79 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 40 pika 8, 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

2.4.6. Per te vertuar perputhshmerine e produkteve, cilesine dhe standartet e kerkuara Operatori Ekonomik duhet te paraqes Certifikat Konformiteti/Test Raport per produktet me numer sipas listes 8, 9, 13, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 27, 52, 54, 56, 75, 91, 92, 95, 96.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 6 germa c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi.

2.4.7.Ofertuesi ne ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesi mostrat pranë Autoritetit Kontraktor.

Produktet për të cilat kerkohen të paraqiten mostrat janë të renditura sipas tabelës më poshtë :

Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
Saldatrice 500 A	Copë	1
Saldatrice 200 A	Copë	1
Saldatrice 130A	Copë	1
Maske saldimi elektronike	Copë	1
Pince saldimi elektrode	Copë	1
Sharre hekuri dore	Copë	1
Sharre druri dore	Copë	1
Pistoletë boje me ajër profesionale	Copë	1
Fresibel I vogël	Copë	1
Fresibel I madh	Copë	1
Fresibel I vogël me bateri	Copë	1
Trapan	Copë	1
Sharre elektrike për prerje metali	Copë	1
Sharre bango metali	Copë	1
Trapan me bateri	Copë	1
Matrapik	Copë	1
Vidator me bateri	Copë	1
Vidator mekanik për goma	Copë	1
Starter baterie 12/24 V	Copë	1
Trapan bango I madh	Copë	1
Morsete e madhe	Copë	1
Pistoletë ajri fryrje	Copë	1
Seri egzagonalesh	Set	1
Seri egzagonalesh yll	Set	1
Set kutia kriketi	Set	1
Krik 50 ton	Copë	1
Leva 600 mm	Copë	1
Leva 900 mm	Copë	1
Leva 1200 mm	Copë	1
Varre	Copë	1

Celes papagall 24"	Copë	1
Celes papagall 36"	Copë	1
Celes papagall 48"	Copë	1
Set kacavidash	Set	1
Set furce pastrami	Set	1
Set pinca	Set	1
Set pinca fermo	Set	1
Set poligon fiso stel	Set	1
Thika Bisturi	Copë	1
Celes 17	Copë	1
Celes 21	Copë	1
Set punto betoni	Set	1
Set punto metalike	Set	1
Pompe lavazhi	Copë	1
Steke lavazhi	Copë	1
Llamp servisi	Copë	1
Havi kallaj	Copë	1
Pistolet ngohje me ekran	Copë	1
Gure bango	Copë	1
Kavo baterie	Copë	1
Pistolet dadicekesh per kamjona elektri	Copë	1
Tub kompresori	Copë	1
Bulino	Copë	1
Punto konike	Copë	1
Set gotash hapese metalike	Copë	1
Valixhe per vegla	Copë	1
Pistolet silikoni	Copë	1
Pistolet silikoni sallam	Copë	1
Furce boje	Copë	1
Set celesash fiso poligon kriket	Set	1
Leva kriketi 1/4	Copë	1
Leva kriketi 3/8	Copë	1
Celes dinanometer	Copë	1
Celes tubolar	Copë	1
Izolant me ngjyra PVC (Rezistent ndaj zjarrit)	Copë	1
Kaliber 200mm	Copë	1
Mates rryme	Copë	1
Cekic 1 kg	Copë	1
Cekic 2 kg	Copë	1
Cekic gome	Copë	1
Dare	Copë	1

Prerese teli	Copë	1
Pinca me regjister	Copë	1
Ekstrator me 2 nofulla	Copë	1
Ekstrator me 3 nofulla	Copë	1
Ekstrator me 3 nofulla	Copë	1
Ekstrator me 3 nofulla	Copë	1
Percinator	Copë	1
Gershere llamarine	Copë	1
Thike prerese	Copë	1
Set limash metali	Copë	1
Celes L 1/2	Copë	1
Paranko 2 ton	Copë	1
Lidhese kriket	Copë	1
Dryn	Copë	1
Transpalete	Copë	1
Fasheta plastike	Copë	1
Mates temperature	Copë	1
Kosha 120 L	Copë	1

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë emërtimin: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistem (SPE).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga pesha dhe rëndësia që ato kanë për mbarëvajtjen e proceseve të punës duke qenë se kërkohen mjete pune të karakterit profesional. Në këtë rast janë përzgjedhur disa nga produktet, të konsideruara nga autoriteti kontraktor si të nevojshme për t’u paraqitur si mostra pasi verifikimi fizik i tyre është vlerësuar i rëndësishëm për shkak të funksioneve speciale të produktit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim i kriterëve teknike

Kriteret teknike të përcaktuara për pajisjet, veglat, makineritë, materialet elektrike dhe aksesorët janë hartuar mbi bazën e nevojave reale të autoritetit kontraktor për garantimin e kryerjes së sigurt, efikase dhe cilësore të punimeve të mirëmbajtjes, riparimit dhe shërbimeve teknike.

Specifikimet si fuqia, tensioni, kapaciteti, dimensionet, pesha, kapaciteti mbajtës, parametrat e punës dhe standardet teknike ndërkombëtare janë vendosur si kërkesa minimale, me qëllim që pajisjet të jenë të përshtatshme për përdorim profesional, të kenë jetëgjatësi, të ofrojnë performancë të qëndrueshme dhe të garantojnë sigurinë e përdoruesve gjatë operimit.

Përcaktimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare (EN, EN IEC, ISO, SSH IEC etj.ose ekuivalente) synon të sigurojë që produktet të jenë të certifikuara, të testuara sipas kërkesave të sigurisë elektrike, mekanike dhe mjedisore, duke garantuar cilësi dhe përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

Kriteret janë hartuar në mënyrë funksionale dhe nuk favorizojnë asnjë markë, prodhues apo origjinë të caktuar. Parametrat teknikë përfaqësojnë vetëm nivelin minimal të performancës që duhet të plotësojnë produktet, ndërsa operatorët ekonomikë mund të ofrojnë pajisje me karakteristika të barabarta ose më të mira, për sa kohë që plotësojnë kërkesat funksionale të autoritetit kontraktor.

Përcaktimi i këtyre karakteristikave është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke garantuar njëkohësisht që mallrat e furnizuara të përmbushin kërkesat operative dhe të sigurojnë përdorim të besueshëm gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës.